



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2023:275043

Datë: 21.02.2025

Numri i dokumentit: 06881209

**C.nr.4650/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shaban Shala, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Y.K. duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve B.B., R.M., A.P., Z.B.dhe A.B. që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson V.H. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, të cilën e përfaqëson me autorizim V.I.Xh. përfaqësuese Ligjore pran të paditurës, me objekt kontesti kompensimin e pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, jashtë seance, me datë 12.02.2025 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**(Pa shqyrtim kryesor)**

**I.APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësve: **B.B., R.M., A.P., Z.B.dhe A.B., DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që paditësit të kompensohen në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

- Paditësit **B.B.**

Për periudhën kohore 01 maj 2022 - 21 nëntor 2022 në shumën prej 356.71 euro;

- Paditësit **R.M.**

Për periudhën kohore 01 maj 2022 - 21 nëntor 2022 në shumën prej 356.71 euro;

- Paditëses **A.P.**

Për periudhën kohore 01 maj 2022 - 21 nëntor 2022 në shumën prej 356.71 euro;

- Paditëses **Z.B.**

Për periudhën kohore 01 maj 2022 - 21 nëntor 2022 në shumën prej 356.71 euro;

- Paditëses **A.B.**

Për periudhën kohore 01 maj 2022 - 21 nëntor 2022 në shumën prej 356.71 euro;

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, që paditësve të paguaj **shumën e përgjithshme prej 1,782.55 euro** me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (11.12.2023), e deri në pagesën definitive si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës, shumën prej 342.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

### **A r s y e t i m**

Paditësit B.B., R.M., A.P., Z.B.dhe A.B. në këtë gjykatë me datë 11.12.2022, përmes të autorizuarit të tyre, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, për pagesën mbi bazën e kompensimit të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësve nuk iu është bërë kompenzimi në pagë i pagesës së përqindjes së inflacionit sipas shkallës së inflacionit për vitin 2022, konkretisht për periudhën maj – nëntor 2022, nga Komuna e Prizrenit siç parashihet në nenin 35 paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të arsimit parauniversitar të datës 22.01.2021, ku parashihet “për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë”. Ashtu që paditësit B.B. të bëhet kompenzimi për pagesën e përqindjes së inflacionit në pagë që do duhej të paguhej nga punëdhënësi, konkretisht shumën  $540 \times 12.97 \% = 70.03$  kompenzim për secilin muaj, dhe atë për periudhën nga muaji 2022 deri në muajin nëntor 2022, konkretisht për 7 muaj në shumën prej  $7 \times 70.03 = 490.21$ , për paditësin R.M. kompenzimi për pagesën e përqindjes së inflacionit në pagë që do duhej të paguhej nga punëdhënësi, konkretisht shumën  $512 \times 12.97 \% = 66.40$ , kompenzim për secilin muaj, dhe atë për periudhën nga muaji 2022 deri në muajin nëntor 2022, konkretisht për 7 muaj në shumën prej  $7 \times 66.40 = 464.80$  euro, për paditësen A.P. kompenzimi për pagesën e përqindjes së inflacionit në pagë që do duhej të paguhej nga punëdhënësi, konkretisht shumën  $491 \times 12.97 \% = 63.68$ , kompenzim për secilin muaj, dhe atë për periudhën nga muaji 2022 deri në muajin nëntor 2022, konkretisht për 7 muaj në shumën prej  $7 \times 63.68 = 445.76$  euro, për paditësen Z.B. kompenzimi për pagesën e përqindjes së inflacionit në pagë që do duhej të paguhej nga punëdhënësi, konkretisht shumën  $508 \times 12.97 \% = 65.88$ , kompenzim për secilin muaj, dhe atë për periudhën nga muaji 2022 deri në muajin nëntor 2022, konkretisht për 7 muaj në shumën prej  $7 \times 65.88 = 461.16$  euro, për paditësen A.B. kompenzimi për pagesën e përqindjes së inflacionit në pagë që do duhej të paguhej nga punëdhënësi, konkretisht shumën  $503 \times 12.97 \% = 65.23$ , kompenzim për secilin muaj, dhe atë për periudhën nga muaji 2022 deri në muajin nëntor 2022, konkretisht për 7 muaj në shumën prej  $7 \times 65.23 = 456.61$  euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për padinë shumën prej 312 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 41 euro.

Me parashtrësën e datës 26.01.2024, paditësit përmes të autorizuarit të tyre kanë bërë precizimin e padisë dhe kanë kërkuar që paditësve të bëhet kompenzimi i pagesës së përqindjes së inflacionit në pagë, sipas shkallës së inflacionit për vitin 2022, konkretisht për periudhën 01 maj 2022 – 21 nëntor 2022, me shkallë të inflacionit 11.6% për pagat bazë të paditësve që ka qenë nga 459.00 euro.

E paditura Komuna e Prizrenit–Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 14.03.2024, ku ka theksuar se e

kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar lidhur me kompensimin ga marrëdhënia e punës. Pretendimet e paditësve se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësit kanë ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtës së saj pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadija e paditësve është e pa bazuar. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditësve është e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditësit të lëshuara nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në Gjimnazin “ Remzi Ademaj ” - Prizren. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet lartësia e pagës bazë e paditësve është 459.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi

me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve” Andaj, gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për paditësin B.B.

- Për periudhën kohore 01 maj 2022 - 21 nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit sipas kërkesës së palës ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 356.71 euro ( $459.00 \times 11.6\% = 53.24 \times 6 \text{ muaj} = 319.46 \text{ euro}$ ) si dhe periudha 21 ditë e muajit nëntor është 37.25 euro ( $53.24 / 30 = 1.77 \times 21 = 37.25 \text{ euro}$ ) =  $319.46 + 37.25 = 356.71$

- Për paditësin R.M.

- Për periudhën kohore 01 maj 2022 - 21 nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit sipas kërkesës së palës ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 356.71 euro ( $459.00 \times 11.6\% = 53.24 \times 6 \text{ muaj} = 319.46 \text{ euro}$ ) si dhe periudha 21 ditë e muajit nëntor është 37.25 euro ( $53.24 / 30 = 1.77 \times 21 = 37.25 \text{ euro}$ ) =  $319.46 + 37.25 = 356.71$

- Për paditësen A.P.

- Për periudhën kohore 01 maj 2022 - 21 nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit sipas kërkesës së palës ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 356.71 euro ( $459.00 \times 11.6\% = 53.24 \times 6 \text{ muaj} = 319.46 \text{ euro}$ ) si dhe periudha 21 ditë e muajit nëntor është 37.25 euro ( $53.24 / 30 = 1.77 \times 21 = 37.25 \text{ euro}$ ) =  $319.46 + 37.25 = 356.71$

- Për paditësen Z.B.

- Për periudhën kohore 01 maj 2022 - 21 nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit sipas kërkesës së palës ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 356.71 euro ( $459.00 \times 11.6\% = 53.24 \times 6 \text{ muaj} = 319.46 \text{ euro}$ ) si dhe periudha 21 ditë e muajit nëntor është 37.25 euro ( $53.24 / 30 = 1.77 \times 21 = 37.25 \text{ euro}$ ) =  $319.46 + 37.25 = 356.71$

- Për paditësen A.B.

• Për periudhën kohore 01 maj 2022 - 21 nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit sipas kërkesës së palës ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 356.71 euro ( $459.00 \times 11.6\% = 53.24 \times 6 \text{ muaj} = 319.46 \text{ euro}$ ) si dhe periudha 21 ditë e muajit nëntor është 37.25 euro ( $53.24 / 30 = 1.77 \times 21 = 37.25 \text{ euro}$ ) =  $319.46 + 37.25 = 356.71$

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (11.12.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të tjera të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 312.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 30.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 342.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe 398 të LPK-së

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**-Departamenti i përgjithshëm-**  
**C.nr.4650/23, datë 12.02.2025**

**G j y q t a r i**  
**Shaban Shala**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2023:275043  
Datë: 21.02.2025  
Numri i dokumentit: 06881209